

Seminar “Fuqizimi i Enteve Kombëtare për Dialogun Social Tre palësh në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi”



Prishtinë 20 janar 2012- Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) më 13 dhjetor 2011 në Torino Itali, ka organizuar Seminar pesë ditor me temën „Fuqizimi i Enteve Kombëtare për Dialogun Social Tre palësh në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi”. Në këtë seminar pjesëmarrëse nga Kosova ishin Shukrije Rexhepi përfaqësuese nga BSPK-ja (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), Zineta Daci nga OEK-u, (Oda Ekonomike e Kosovës) dhe Fatime Rexhepi nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale).

Seminari u mbajt në 4 (katër) sesione me ekspertë të Dialogut Social, Ligjit të Punës dhe Marrëdhënieve të Punës nga Irlanda, Holanda dhe Belgjika, të cilët prezantuan eksperiencat e mekanizmave kombëtar të Dialogut Social.

Delegacioni nga Kosova, ishte aktive në diskutime ashtu edhe në grupe punuese si në çështjet rreth Kornizës aktuale institucionale (partnerë të cilët zhvillojnë dialogun social tre palësh); mandatet dhe kompetencat e Enteve Trepalëshe Qendrore; Metodrat e punës dhe procesi i vendimmarrjes; Niveli i përfaqësimit, Struktura dhe financimi; Sekretariati dhe burimet; mediat dhe Rrjetet Ndërkombëtare.

Qëllimi dhe rëndësia e këtij seminari ishte shkëmbimi i përvojave, njohurive dhe dështimeve në mes të shteteve. E veçanta e këtij Seminari ishte prezantimi i Draft- Udhëzuesit për Dialogun Social i cili së shpejti do të jetë në dispozicion të Partnerëve Social. Udhëzuesi i Dialogut Social do ti shërbej Qeverisë si dhe akterëve social për funksionimin e dialogut Social.

Bazuar në prezantimet e pjesëmarrësve u sollën këto konkluzione:

- Forcimi i pozitës së barabartë të partnerëve social;
- Zhvillimi i aftësive negociuese për partnerët social;
- Fuqizimi i partnerëve Social karshi Qeverisë;
- Mbështetja dhe zhvillimi i dialogut dy palësh;
- Krijimi dhe implementimi i ligjeve për çështje sociale, me rregulla sa më të thjeshta në mënyrë që të mund të zbatohen ligjet si të tilla dhe të mund ti zbatojnë të gjithë;
- Forcimi i Këshillit Ekonomiko Social në nivel lokal;
- Sigurimi i buxhetit për KES-in;
- Nevoja e angazhimit të një koordinatori për KES-in;
- Të merren rregullisht informacione rreth asaj se çka është duke punuar ILO-ja;
- Për opinion të bëhet identifikimi, publikimi dhe shënimi i të ariturave të KES-it. ***